



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:269359
Datë: 07.09.2023
Numri i dokumentit: 04658159

C – IV. – 14 - 4522

Paditësi:

M B nga V P, O, V P, Republika e Sërbisë i përfaqësuar nga Projekti për Ndihmë Juridike të Personave të Shpërngulur dhe refugjatë me seli në Graçanicë.

Kundër

Të paditurës:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lagjja, ”Lakrishtë”, Prishtinë.

Për : Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykatësi i vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.07.09.2023**, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si i pabazuar kërkesëpadia e paditësit, M B nga V P Republika e Serbisë dhe Vendimi, GJI002 -0262 i dt.12.05.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, **VËRTETOHET, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi me dt.12.06.2014 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), ka paraqitur ankesë kundër Vendimit, GJI002 -0262 i dt.12.05.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e me të cilin, të njëjtit i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri në vitin 2003 nga Ndërmarrja

Shoqërore, (NSh) ”Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore” me seli në Ferizaj (në Likuidim) dhe se përmes kësaj anekese, ka kërkuar nga gjykata që pas shikimit në të gjitha shkresat e lëndës, të nxjerr Vendim e me të cilin të anulohet Vendimi i dt.12.05.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL)

të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në lëndën, GJI002 – 0262 dhe lënda të kthehet në shqyrtimit të serishëm ose që të bie vendimin e vet e me të cilin do të aprovohet kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € nga të hyrat e likuidimit të NSh, "Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore" me seli në Ferizaj derisa i ka propozuar gjykatës që të lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës si dha nga pagimi i taksës gjyqësore pasi që është person i zhvendosur dhe i gjendjes së dobët ekonomike dhe se kjo gjykatë, me aktvendimin e saj, C – IV. – 14 – 4522 të dt.19.06.2023, ka pranuar pjesërisht si i bazuar kërkesën e paditësit, M B nga V P, Republika e Serbisë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore kurse pjesërisht e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si "ankesë", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi kësaj padie, ia ka bashkangjitur provat : kopjen e Vendimit, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL), kopjen e faqeve të vërtetuara të librezës së punës, nr.4727/72 , kopjen e Formularit të AKP-së të plotësuar nga paditësi të dt.18.01.2008 e të dërguar përmes Zyrës së UNMIK-ut në Beograd, kopjen e Formularit të AKP-së të plotësuar nga paditësi të dt.10.04.2007 e të dërguar përmes Zyrës së UNMIK-ut në Beograd, kërkesën e dt.09.06.2014 të paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore dhe ndihmës për përkthim dhe Vërtetimin, Nr.1721 – 9 – 171/03 – 114/2014 – 3021 të dt.09.06.2014.

Me dt.31.03.2023, e paditura, AKP-ja, ka paraqitur mbrojtjen në ankesën e paditësit të ushtruar kundër Vendimit, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, se i përmbahet qëndrimin se autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, duke pretenduar se padia e paditësit, është e pa pranueshme sipas Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, dhe të nenit 74.2 të Ligjit, Nr.04/086 për Dhomën e Posaçme, si dhe kërkesa e tij, se kërkesa e parashtresës i referohet shumës së tre pagave të papaguara që pretendohet të mos jenë paguar, dhe se sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, AL-ja, ka shqyrtuar kërkesën dhe e vlerëson si të pavlefshme ku parashikon se "elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976) ku parashikon se "... pagesa e pagës apo rrogës apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet, dhe se kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo para ndonjë organit tjetër kompetent brenda tre viteve dhe i paraqet gjykatës që t'a refuzoj si të pa pranueshme dhe të pa bazuar të ankesën e paditësit dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit nr.06/L – 086.

Me dt.03.04.2023, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 4522 të dt.03.04.2023, mbrojtjen e të paditurës, AKP-së, ia ka dërguar paditësit përmes Zyrës për Ndhimë Juridike të Personave të zhvendosur dhe refugjatëve me seli në Graçanicë për mundësinë e paraqitjes së Përgjigjes në mbrojtjen e të paditurës por pas pranimit të këtij Urdhri e pas kalimit të afatit të dhënë në këtë urdhër por edhe deri më tani, nuk ka prova se paditësi, ka paraqitur Përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e padisë së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar, se NSH, ”Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore” me seli në Ferizaj (në Likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.23.09.2013, derisa pala paditëse, me dt.14 Nëntor 2014, pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri me në vitin 2003 nga Ndërmarrja Shoqërore, (NSH) ”Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore” me seli në Ferizaj (në Likuidim) dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi dhe se me Vendimin, GJI002 – 0262 të dt.12.05.2014 të AL-së, kërkesën në fjalë të paditësit, e ka refuzuar si të pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit, ankesën kundër Vendimit, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, pranë DHGJSK-së, e ka paraqitur me dt.12.06.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve (ky Vendim i AL-së, është përcjellë te pala paditëse, me dt.15.05.2014) dhe se padisë/ankesës së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi pra Vendimit, GJI002 – 0262 të dt.12.05.2014 të Autoriteti të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, (NSH) ”Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore” me seli në Ferizaj (në Likuidim) .

Në nenin 36 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) që flet për pranueshmërinë e një kërkesë/ankese, aty thuhet se : *....kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme; kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji. është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa”*.

Në nenin 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) që flet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim aty thuhet se

''Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi''.

Në nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, parashihet se : *''Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit''.*

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga dispozitat e lartë cekura ligjore por edhe se e njëjta padi/ankesa, pranë e DHPGJSK-së, është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 të Autoriteti të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) ''Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore'' me seli në Ferizaj (në Likuidim) por se kërkesëpadija e paditësit, është e papabuar.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) ''Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore'' me seli në Ferizaj (në likuidim, kanë pasur raport të marrëdhënies së punës dhe atë prej dt.11.09.1973 dhe se ka punuar deri me dt.22.04.1993 por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore që paditësi pretendon se ka të drejtë që të kërkojë nga e paditura Ndërmarrja Shoqërore në fjalë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri me në vitin 2003 si dhe këtë kërkesë a e ka bërë brenda afateve të parapara ligjore.

Në nenin 40 par.1 pika 6.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty thuhet se : *Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: 1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim: 47 1.6.1.kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person; ,, ''.* Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar nga paditësi është refuzuar me vendimin e AL-së mbi bazën e dispozitave ligjore nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP lidhur me nenin 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (1976), duke e konsideruar se kërkesa është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësi, nuk ka arritur që të bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore duke ushtruar padi për kompensim nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, kanë në dispozicion arkivat për lëndën aktive të iniciuara nga palët para vitit 1999 dhe me kërkesë të palës nxjerrin parashtrësia për të dëshmuar iniciimin e procedurave gjyqësore.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *''Palët, në parashtrësat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës''* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *''... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme''* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (I publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *''Pagesa e shumë s të pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet''* e për më tepër edhe në nenin 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Paditësi, kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri me në vitin 2003 dhe se sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, e ka bërë brenda afatit ligjor mirëpo kërkesa e tij është refuzuar si e pa vlefshme me Vendimin e Autoritetit të likuidimit të AKP-së, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 dhe atë për shkak të parashkrimit të kërkesës kurse edhe ankesën kundër këtij vendimi, pranë Dhomës së Posaçme, e ka bërë brenda afati të paraparë ligjor për ushtrimin e saj dhe atë sipas nenit 37.7 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë datën 1 korrik 1999, si datë e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit kur parashtruesi i ankesës/ paditësi, nuk ka përfituar të ardhurat personale të pretenduara nga Ndërmarrja Shoqërore, (NSh) *''Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore''* me seli në Ferizaj (në likuidim), si e paditur dhe se në bazë të dispozitave së mësipërme ligjore, kërkesa nga ana e paditësit, para dt.14.11.2013, do të duhej të parashtrohej pranë ndonjë gjykate apo autoriteti kompetent brenda 3 (tre) vjetëve nga momenti kur parashtruesi - paditësi, e kishte fituar të drejtën për të dorëzuar kërkesën për kompensim për pagat e papaguara, pra duke filluar nga data 01 korrik 1999 si dhe momenti kur NSh-ja në fjalë, nuk ka pasur sukses që t'ia përmbush kërkesën parashtruesit të kërkesës e cila rrjedh nga marrëdhënia e punës dhe se sipas vlerësimit të gjykate, kërkesa e parashtruesit të ankesës/paditësit lidhur me kompensimin e pagave të papaguara gjegjësisht kërkesa për pagën e fundit të kërkuar për vitin 2003, është parashkruar më 01.06.2009 kurse pagat e pretenduara të më hershme janë parashkruar në përllogaritje me kohën veç e veç për secilën pagë mujore të pretenduar me kalimin e afatit prej 3 vite ndërsa kërkesa e saj është parashtruar fillimisht në Autoritetin e Likuidimit me dt.14.11.2013 kurse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGKSK), është parashtruar ankesë me dt.12.06.2014 dhe atë kundër Vendimit të AL-së, GJI002 – 0262 i dt.12.05.2014 për Ndërmarrjen Shoqërore, (NSh) *''Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore''* me seli në Ferizaj (në likuidim), e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për pagat e pa paguara për periudhën e lartë cekur kohore dhe atë për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar, është jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësi, nuk ka arritur që të bind gjykatën se para vitit 2006, ka iniciuar procedurën gjyqësore duke ushtruar padi për kompensim nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, kanë në dispozicion arkivat për lëndën aktive të iniciuara nga palët para vitit 1999 dhe me kërkesë të palës nxjerrin parashtrësia për të dëshmuar iniciimin e procedurave gjyqësore. Andaj gjykata konstaton se kërkesën mbi

bazën e fakteve të paraqitura të paditësit para AL-së dhe tani para gjykatës nuk mund të marrë si të besueshme në aprovimin e kërkesës gjegjësisht ankesës së paditësit, në shqyrtimin e mëtejshmë të fakteve vendimtare lidhur me provat e prezantuara ka gjetur se me Vendimin e tij, GJI002 – 0262 të dt.12.05.2014, AL-ja, drejtë ka vepruar me rastin e refuzimit të kërkesës për shkak të kufizimeve të afateve ligjore për të kërkuar për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri me në vitin 2003 dhe se për këto arsye, kërkesa e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar dhe atë për shkak të parashkrimit të saj.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se, qëndrimi i të paditurës se kërkesa e parashtruesit- paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 16,000.00 € për periudhën prej muajit Qershor 1999 e deri me në vitin 2003 e që pretendohet të mos i jenë paguar sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), është i drejtë, duke vlerësuar si të pavlefshme kërkesën e tij mbi bazën e parashkrimit të saj, andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesëpadinë e paditësit, M B nga V P Republika e Serbisë, duhet t'a refuzoj si të pabazuar derisa Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), GJI002 – 0262 të dt.12.05.2014 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) "Fabrika e Vajit dhe Yndyrave Bimore" me seli në Ferizaj (në Likuidim), duhet t'a vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:269359, 07.09.2023

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda 15 (pesë mbëdhjetë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).